

AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI  
I  
Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar  
“ÇELA COLOR” Shpk

**KAPITULLI I**  
**Emri,forma,selia,kohezgjatja**

**Neni 1 Data e themelimit dhe Emri**

- 1.1 Me efekt nga data **02/03/2022** themelohet shoqeria “ÇELA COLOR” (ne vijim “Shoqeria”) e ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi “Shpk”, I cili perfaqeson formen ligjore te saj, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuara.
- 1.2 Ortaket e Shoqerise (“Ortaket”) gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.
- 1.3 Ne te gjithe dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri I saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga:
  - 1.3.1 Fjalet “Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar” ose “Shpk”
  - 1.3.2 Numri I identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj
  - 1.3.3 Adresa e regjistruar
  - 1.3.4 Pasqyrimin e faktit qe shoqeria eshte ne procedura likuidimi, ne qoftese ky rast paraqitet.
  - 1.3.5 Kapitalin e regjistruar te Shoqerise dhe kapitalin e paguar te Shoqerise

**Neni 2 Forma Ligjore**

- 2.1 Shoqeria eshte nje entitet Shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (“shoqeri me pergjegjesi te kufizuar”), ne perputhje me ligjin Nr.9910, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (“Ligji I Shoqerive”).

**Neni 3 Selia**

- 3 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: **DURRES Lagjja nr.13, Rruga Pavarsia,pasuria nr.38/216 ND-G, zona kadastrale 8518**. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi Brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

**Neni 4 Kohezgjatja**

- 4.1 Kohezgjatja e Shoqerise eshte e pacaktuar.



## KAPITULLI II

### Neni 5 Objekti I shoqerise

5.1 Objekti aktivitet I Shoqerise do te jete te kryej cdo aktivitet tregtar te lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanerisht sa me poshte:

**Tregti te artikujve industriale, sherbime kundrejt ndermarrjeve, sherbime ne punet e ndertimit si Hidraulik, elektrik , murature, karpentier etj**

Per te arritur qellimin e objektit te shoqerise, ajo mund te kryejë të gjitha transaksionet industriale, komerciale dhe financiare jo me publikun, me pasuri të luajtshme dhe pasuri të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme, me përjashtimin e shprehur të atyre që rregullohen me ligje të veçanta. Shoqeria gjithashtu do të jetë në gjendje të japë garanci, dhe përkrahje për të garantuar detyrimet e veta dhe të supozuara nga palët e treta për atë shoqeri, duke përfshirë marrjen e interesave dhe investimeve në kompani të tjera dhe / ose konsorcium të kompanive që kanë objekte të ngjashme, apo të lidhura me te. Shoqeria gjithashtu mund të kërkojë të gjitha financimet dhe / ose kontributet e kërkuara nga ligjet në fuqi për arritjen e qëllimit të Saj.

### Neni 6 Ndryshime

6.1 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

## KAPITULLI III

### **Kapitali Themeltar, Kuotat e kapitalit Themeltar**

### Neni 7 Kapitali themeltar

7.1 Kapitali I Shoqerise eshte **16.000 EUR**, e konvertuar me kursin e dites se sotme date 02.03.2022 te Bankes se Shqiperise 1EUR= 121.4 ALL, ne total **1 942 400 ALL** (nje milion e nenteqinde e dyzete e dy mije e katerqinde leke), plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera. Ky kapital eshte I barabarte me 1 (nje) Kuote me vlere nominale **1 942 400 ALL** (nje milion e nenteqinde e dyzete e dy mije e katerqinde leke), plotesisht te nenshkruara dhe te pashlyera.

7.2 Kapitali I Shoqerise do te shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese.

### Neni 8 Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat

8.1. Ortaket e shoqerise dhe kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri jane si meposhte:

**RUSHIT ÇELA** lindur me 29.08.1985 ne Selce e Poshteme,dhe banues ne Lagja 13 Plazh, Durres, i njohur dhe i identifikuar nepermjet numrit Personal te kartes ID I50829037G person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, do te njihet si ortaku i vetem i shoqerise dhe zoterues i 1 (NJE) kuote, me vlere nominale **1 942 400 ALL** (nje milion e nenteqinde e dyzete e dy mije e katerqinde leke) .

### Neni 9 Zvogelimi ose Zmadhimi I Kapitalit Themeltar



9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjit te Shoqerive.

9.2 Zmadhimi I kapitalit mund te realizohet ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave (nese ka) dhe fitimit.

9.3 Rritja e kapitalit do te behet me kuota te reja apo me rritjen e vleres se kuotave ekzistuese. Pjeset e reja te kapitalit themeltar do te nenshkruhen dhe vlera e tyre nominale do te paguhet plotesisht.

9.4 Zmadhimi I kapitalit nuk do te dobesoje pjesen e interest te Ortakeve ne Kapitalin e Shoqerise, pervecse kur vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, vendim I cili meret me nje shumice prej  $\frac{3}{4}$  e votave.

9.5 Shoqeria nuk mund te bleje asnje kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin/Administratoret te bejne blerjen e kuotave perkatese apo pjese te tyre dhe ti anullojne ato.

### **Neni 10 Te drejttat dhe detyrimet e Ortakeve**

10.1 Ortaket jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.

10.2 Cdo Ortak do te kete te drejta vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("Asambleja e Pergjithshme") ne perpjestim me vleren nominale te kuotes qe zoteron. Cdo Ortak ka te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, nese Asambleja e Pergjithshme vendos te shperndaje fitimet, sikunder te drejttat e parashikuara nga ky Statut, per cdo marreveshje te detyrueshme ndermjet Ortakeve dhe dispozitave ligjore te Ligjit te Shoqerive.

10.3 Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojne dokumentat dhe raportet e Shoqerise.

10.4 Te drejttat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.

10.5 Detyrimet e Shoqerise jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne pergjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne. Ortaket nuk mbajne pergjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne).

10.6 Shoqeria nuk mban pergjegjesi per borxhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

### **Neni 11 Transferimi I pjeseve te Kapitalit**

11.1 Pjeset e kapitalit transferohen lirisht midis ortakeve.

11.2 Ne rast se nje Ortak do te shese, transferoje, ose perdore ne menyra te ndryshme pjese apo te gjitha kuoten e tij Ortaku tjetere do te kete te drejten e parablerjes, kundrejt bleresve te tjere. Nese Ortaku me te drejte parablerjeje do te kete bere nje oferte dhe kjo oferte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere Ortaku tjetere do te rishikojte oferten e bere dhe do t'i beje Ortakut qe shet nje oferte te dyte. Nese edhe kjo oferte e dyte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere ky i fundit (Ortaku qe shet) nuk do te kete te drejte te shesi kuoten tek nje bleres tjetere me cmim me te ul et se cmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar ne oferten e dyte.



11.3 Cdo transferim i kuotave do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive dhe duhet te regjistrohesh prane Qendres Kombetare te Biznesit.

## **KREU IV**

### **Asambleja e Pergjithshme**

#### **Neni 12 Kompetencat**

12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.

#### **Neni 13 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme**

13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten I here ne vit.

13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane nje vlere me te larte se 5% e te gjitha aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t' i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

13.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, I pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.

13.6 Ortaket do te organizojne takime me Administratoret te pakten nje here ne vit me qellim vleresimin e veprimtarive te kryera nga Administratoret, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perfshire ceshtje per te cilat Administratoret nuk bien dakord.

13.7 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.6 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.



## **Neni 12 Menyra e Thirrjes se Mbledhjeve**

14.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj nepermjet thirrjes se mbledhjeve ose nepermjet konsultave me shkrim.

14.2 Asambleja e pergjithshme mund te thirret nga nje prej Administratoreve ose nga cdonjери prej Ortakeve.

14.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vendi i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe rendi i dites perkates i mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithе Ortaket bien dakort.

14.4 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqesohet nga nje person tjetер ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.

14.5 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t' u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe iu eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke I kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundershite e lyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne administratoreve te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres.

14.6 Secili prej Ortakeve ka te drejten te votoje ne perputhje me kuoten e zoteruar prej tij ne kapital.

14.7 Vendimet e meposhtme do te miratohen me miratimin e Ortakeve qe zoterojn te pakten 75% te kapitalit te Shoqerise:

- (i) Pagesa e cdo dividenti ne kesh apo natyre Ortakeve te Shoqerise;
- (ii) Nenshkrimi i marreveshjeve financiare ne lidhjeme Shoqerine apo nxjertja e instrumentave te borxhit nga Shoqeria;
- (iii) Blerja e cfaredolloj kuote apo interesi tjerter ne cdo biznes dhe sipermarrje;
- (iv) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise sic eshte percaktuar ne Nenin 7 te kesaj Marreveshje;
- (v) Ndryshime dhe amendime te ketij Akti Themelimi; dhe
- (vi) Likuidimi apo shpemdarda e Shoqerise.

14.8 Atehere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter public Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjit Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).

14.9 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.

14.10 Administratoret duhet te mbajne procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

### **Neni 15 Perjashtimi nga e drejta e votes**

15.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme eshte duke vendosur mbi:

- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
- (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
- (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi sikunder Ortaku te cilin perfaqeson.

## **KREU V Administratoret**

### **Neni 16 Bordi I Administratoreve dhe kompetencat**

16.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administratoret mund te jene te cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jene rezidente ne Shqiperi.

16.2 **ADELINA ÇELA** lindur me 22.07.1986 ne Terbuf,dhe banues ne Durres, Lagjja 13 Plazh e njohur dhe i identifikuar nepermjet numrit Personal te Kartes se ID I65722048R, person madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, do te njihet si administrator e Shoqerise.

16.3 Kohezgjatja e funksionit te Administratoreve eshte per nje periudhe prej **5** vjetesh,me te drejte rinovimi kontrate per periudhe te ngjashme kohore, duke filluar qe nga momenti kur kjo detyre merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi prane Qendres Kombetare te Biznesit), me te drejte riprteritje te ketij mandati.



16.4 Menjehere pas pranimit te emerimit te tyre, Administratori(et) njohin nese maredhenia e tyre me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tyre nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.

16.5 Ortaket kane te drejten te shkarkojne Adminsitratoret me shumice te thjeshte votash.

16.6 Nese Administratoret e Shoqerise nuk arrijne te bien ne nje mendim te perbashket lidhur me mbylljen, perfundimin ose ndryshimin e transaksioneve, kontratave apo veprimeve te tjera, ceshtja do te referohet tek Ortaket.

16.7 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit(eve) kane fuqi vepruese, Administratori(et) kane te drejten te marrin vendime ne lidhje me detyrat e tyre pa qene fizikisht present ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria u rimburson Administratorit(eve) shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Adminsitratoret(eve) ne vende qe nuk jane Brenda qytetit te residences se Administratorit(eve).

### **Neni 17 Kompetencat dhe detyrimet**

17.1. Kompetencat e Administratorit ne kuader te perfaqesimit te Shoqerise perfshijne:

- i. Thirrjen e Asamblese se Pergjithshme, ne rastet e specifikuar ne nenin 13.
- ii. Menaxhimin e aktivitetit tregtar te shoqerise nepermjet implementimit te politikave dhe planeve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.
- iii. Perfaqesimin e Shoqerise.
- iv. Kujdesin per mbajtjen ne menyre te pershtatshme te dokumentave dhe librave kontabel te Shoqerise.
- v. Pergatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit te konsoliduar dhe raportit te ecurise se veprimtarise se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve qe i paraqiten per miratim Asamblese se Pergjithshme.
- vi. Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit, kur eshte e nevojshme.
- vii. Raportimin perpara Asamblese se Pergjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
- viii. Kryerjen e detyrave te tjera te caktuara ne ligj dhe nga Ortaket.

17.2. Administratori(et) mbikqyrin dhe sigurojne qe zyrtaret, agjentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise. Administratori(et) duhet te raportojne tek Ortaket ne lidhje me personat te cilet emerohen nga Ortaket.

### **Neni 18 Detyrimi I besnikerise dhe pergjegjesia**



18.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14, 15, 16, 17 e 18 të Ligjit të Shoqërisë,

Administratores detyrohen:

- i. të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në këtë Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
- ii. të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- iii. të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- iv. të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- v. të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm

18.2 Administratores gjatë kryerjes së detyrave të tyre përgjigjen kundrejt shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprim apo mosveprim është kryer në mirëbesim.

18.3 Në rast të shkeljes së detyrës dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 të këtij neni, Administratori është i detyruar të demshpërblejë Shoqërinë, për demet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.

18.4 Në veçanti, Administratori është i detyruar të demshpërblejë Shoqërinë, për demet, neqoftese në kundërshtim me Ligjin e Shoqërisë kryen veprimet e mëposhtme:


- i. I kthen Ortakëve kontributet;
- ii. I paguan ortakëve interesat apo dividente;
- iii. I shpërndan asetet Shoqërisë;
- iv. lejon që Shoqëria të vazhdojë aktivitetin e saj, kur duhet të kishte parashikuar që kjo e fundit nuk do të kishte aftësi të paguara për të shlyer detyrimet e saj.
- v. jep hua.

## **KREU VI** **Administrimi Financiar I Shoqërisë**

### **Neni 19 Eksperti Kontabel I Autorizuar**

19.1 Ortaket mund të caktojnë ekspertin kontabel të autorizuar për t'i shërbyer Shoqërisë.

19.2 Ekspertet duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.





## **KREU VII** **Aktiviteti Shoqerise**

### **Neni 20 Viti ekonomiko-financiar**

20.1 Viti ekonomiko-financiar fillion ne ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon ne ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar nis ne datën e themelimit të Shoqerise.

### **Neni 21 Mbajtja e Llogarive**

21.1 Shoqeria do të mbajë llogarite ne lekë dhe ne monedhe të huaj.

### **Neni 22 Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit**

22.1. Fitimi i Shoqerise përcaktohet ne baze të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme ne përputhje me Statutin, marrëveshjen e Ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.

22.2. Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezerve ne përputhje me kushtet e Legjislacionit shqiptar për fondin rezerve të detyrueshem.

22.3. Ne baze të Ligjit për Shoqerite, Shoqeria mund të shpërndajë fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shpërndarje:

- i. asetet e Shoqerise mbulojnë teresisht detyrimet e kesaj të fundit;
- ii. Shoqeria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që behen të kerkueshme brenda 12 muajve të ardhshem.

22.4. Administratoret leshojne një certifikate të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 22.3 me sipër. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush keto kritere, administratoret nuk mund ta leshojne këte certifikate.

22.5. Administratoret përgjigjen ndaj Shoqerise për vertetësinë e certifikates së aftësisë paguese.

## **KREU VIII** **Modifikimi I Formes Ligjore. Prishja**



### **Neni 23 Modifikimi I Formes Ligjore**

23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme ne perputhje me dispozitat respektive ne Legjislacionin Shqiptar.

23.2. Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

### **Neni 24 Prishja e Shoqerise**

24.1 Shoqeria mund te priset ne rrethanat e meposhtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) hapje e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr. 9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per arsye te tjera te parashikuara nga Ortaket ne cdo kohe;

24.2 Administratori(et) regjistrojne prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Bizensit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723 date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Ne rast se prishja e Shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ia njofton vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

## **KREU IX Te ndryshme**

### **Neni 25 Largimi I ortakut**

25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga nenet 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive.

### **Neni 26 Te tjera**

26.1. Cdo ceshtje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

## **Nenshkrimi I Themeluesve/Ortakeve**

"ÇELA COLOR" Shpk

RUSHIT ÇELA



